

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Valdete Daka dhe Nesrin Lushta, anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të dënuarit H.I., nga fshati T., komuna e Vitisë, për shkak të një veprë penale të fajdesë në tentativë nga neni 343 par.3 lidhur me nenin 28 të KPK dhe tri veprave penale të fajdesë nga neni 343 par.1 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, avokat Y.H., e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan-Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.246/2014 datë 28.12.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.104/2016 datë 31.8.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur, më 30 prill 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit H.I., ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan-Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.246/2014 datë 28.12.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.104/2016 datë 31.8.2016.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjilan-Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.246/2014 datë 28.12.2015, i dënuari H.I. është shpallur fajtor për veprat penale fajde në tentativë nga neni 343 par.3 lidhur me nenin 28 të KPK dhe tri veprave penale të fajdesë nga neni 343 par.1 të KPK, për të cilat është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 7 (shatë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 2.10.2014 deri më datën 26.1.2015 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 26.1.2015 deri më datë 4.8.2015 dhe me dënim unik me gjobë në shumë prej 1.600 €. I dënuari është i obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 50 €.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.104/2016 e datës 31.8.2016, ka aprovuar pjesërisht ankesën e mbrojtësit të të

dënuarit H.I. edhe sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm sa i përket vendimit për dënimin me burgim ashtu që Gjykata e Apelit duke ia marrë si të vërtetuara dënimet me burgim për veprat penale për të cilat i dënuari është shpallur fajtor dhe atë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti për veprën penale nën pikën I të dispozitiv të aktgjykimit nga neni 343 par.3 lidhur me nenin 28 të KPK, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj, për veprën penale nën pikën II – nga neni 343 par.1 të KPK, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, për veprën penale nën pikën III nga neni 343 par.1 të KPK dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj për veprën penale nën pikën IV – nga neni 343 par.1 të KPK dhe konform dispozitës së nënti 80 par.2 nënpar.2 të KPK e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 4 (katër) muaj, në të cilin dënimi i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 2.10.2014 deri më datën 4.8.2015. Dënimi unik me gjobë në shumë prej 1.600 € i shqiptuar për veprat penale të lartcekura është marrë si i vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. Y. H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 e lidhur me nenin 370 të KPPK si dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 343 i KPK, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim si dhe të ndërpritet ekzekutimi i aktgjykimit të formës së prerë deri në vendosje sipas kërkesës.

Prokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.45/2017 e datës 16.3.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar nga mbrojtësi i të dënuarit H.I.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes e në kuptim të dispozitës së nenit 345 par.1 dhe 346 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 lidhur me nenin 370 të KPPK, meqë në aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat janë ato fakte të cilat gjykata i ka konsideruar si të vërtetuara kur i dënuari është shpallur fajtor dhe gjykuar e të cilin aktgjykim e vërteton edhe gjykata e shkallës së dytë. Kështu, mbrojtja konsideron se aktgjykimi i shkallës së parë ka kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit, kundërthënie këto që konsistojnë në faktin se në dispozitivin nën pikën I thuhet se të dënuarit H.I. i dëmtuari F., në emër të kamatës ia ka paguar shumën prej 11.990 €, ndërsa në arsyetim ceket shuma prej 11.900 €, e njëjta kundërthënie qëndron edhe në raport me shumën 24.000 € e cila është në dispozitiv nën pikën I ndërsa në arsyetim ceket shuma prej 25.000 €, si dhe në të njëjtën dispozitiv ceket "... në këtë mënyrë arrijnë që nga shuma prej 3.400 €,

në mënyrë të kundërligjshme të përfitoj 36.900 €, ndërsa në arsyetim të aktgjykimit konstatohet se "... i dëmtuari për t'ia kthyer borxhin dhe kamatën prej 25.000 € vëllait të akuzuarit P.I., t'ia shes lokalin afarist që gjendet në Ferizaj apo në Viti, për shumë prej 36.000 €...". Edhe sa i përket dispozitivit nën pikën II të aktgjykimit të shkallës së parë ka kundërthënie të tilla ku në dispozitiv theksohet "...gjatë muajit tetor 2012"... ndërkaq në arsyetim ceket "... gjatë muajit shtator 2012" dhe nuk është e qartë se a i ka huazuar i dëmtuari M. nga i dënuari H.I. shumën e cekur në muajin shtator apo në muajin tetor të vitit 2012, edhe pse në fakt i dëmtuari gjatë shqyrtimit gjyqësor në tërësi mohon faktin të ketë marrë para hua nga i dënuari. Edhe dispozitivi nën pikën III të aktgjykimit të shkallës së parë ka kundërthënie ashtu që në dispozitiv thuhet "... të dëmtuarit A.D., nga Ferizaj ia jep shumën e të hollave prej 20.000 €, duke e detyruar që për këtë shumë të lënë peng lokalin afarist ...", ndërkaq në arsyetim konstatohet se "...P.I., të dëmtuarit A. në llogarinë bankare në emër të shitblerjes ia transferon shumën prej 20.000 €...", çka jep për të kuptuar se të dëmtuarit A. nuk i ka dhënë i dënuari shumën prej 20.000 €, por që këtë shumë në llogarinë bankare të tij e ka bartur P.I., duke vazhduar me kundërthënie të njëjta të cilat janë edhe në dispozitivin nën pikën IV të aktgjykimit të shkallës së parë ku thuhet se "...të dëmtuarit S.F., nga fshati S. e J., ia ka dhënë shumën e të hollave prej 9.000 € me kamatë mujore prej 10%...", ndërsa në arsyetim thuhet "...këtë huazim e ka kthyer në mars të vitit 2014...", që do të thotë se paratë janë dhënë me huazim por jo me interes siç konstatohet në dispozitiv të aktgjykimit. Mbrojtja më tutje konsideron se është shkelur dispozita nenit 132 par.6 të KPPK, meqë ka qenë obligim i Prokurorit që me shkrim të njoftoj të gjitha palët lidhur me datën, kohën dhe vendin ku do të merren deklaratat në procedurë paraprake edhe pse mbrojtja këtë e ka kërkuar dhe gjykata është dashur ta mbështes aktgjykimin vetëm në deklaratat e dhëna në shqyrtim gjyqësor.

Nga gjendja e përshkruar më lartë mbrojtja konsideron se me aktgjykimet e kundërshtuara është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit meqë nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i dënuari ka kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor dhe dënuar.

Gjykata Supreme duke i vlerësuar pretendimet e potencuara në kërkesë gjen se dispozitivet e aktgjykimeve të kundërshtuara janë të qarta, nuk kanë kundërthënie me vetveten e as me shkresat e çështjes dhe se në arsyetim janë dhënë të gjitha arsyet ligjore lidhur me faktet vendimtare në bazë të cilave është gjykuar i dënuari. Kështu qëndron fakti se në dispozitivin I ka disa "gabime teknike" lidhur me shumën e kamatave dhe përfitimeve të kundërligjshme dhe se thuhet "...t'ia kompensoj shumën prej 11.990 €..." ndërsa në arsyetim thuhet shumën prej 11.900 €, por nga shkresat e çështjes rezulton se bëhet fjalë për shumën prej 11.900 €. Edhe sa i përket pretendimeve tjera kjo Gjykatë gjen se nuk janë të qëndrueshme, kështu edhe pse qëndron fakti se në dispozitivin nën pikën I thuhet se "... i dëmtuari F.S., detyrohet që t'ia paguajë shumën prej 24.000 € të dënuarit..." ndërsa në arsyetim thuhet se kemi të bëjmë me shumën prej 25.000 €, është evidente se nga shkresat e çështjes kemi të bëjmë me shumën prej 25.000 € (baza e borxhit dhe kamata nga prilli i vitit 2014) dhe se kemi të bëjmë me

gabime teknike. Për të gjitha këto pretendime janë dhënë arsye ligjore nga gjykata e shkallës së parë dhe e dytë e të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë. Sa i përket pretendimit se në dispozitivin II si kohë e kryerjes së veprës penale ceket muaji tetor, ndërsa në arsyetim muaji shtator, kjo gjykatë gjen se me rëndësi është se në veprimet e të dënuarit përmbushen elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor ,pra nga shkresat e çështjes vërtetohet se i dënuari ia ka dhënë 500€ hua me kamatë mujore prej 5%,dhe për këtë të dy gjykatat kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm ligjor. Sa i përket veprës penale nën dispozitivin III të aktgjykimit dhe pretendimeve se ka kundërthënë kjo gjykatë gjen se nga shkresat e lëndës konstatohet, e sidomos nga deklarata e të dëmtuarit A.D., se i dënuari ia kishte dhënë hua shumë prej 20.000 € me kamatë mujore prej 10% dhe se sipas marrëveshjes këto para janë deponuar në llogari të tij ,ndërsa i njëjti për këtë shumë ia ka shitur lokalin afarist P.I., këtu vëllait të dënuarit, dhe se në llogarinë e tij janë deponuar 20.000€ në emër të para kontratës, dhe se i njëjti i ka tërhequr vetëm 10.000€ ,edhe pse vlera reale e këtij lokali ishte 100.000 €. Ndërsa se i dëmtuari S.F., ka huazuar me kamatë prej 10% shumë prej 9.000€ vërtetohet nga vet deklarata e tij dhënë në polici dhe kjo deklaratë përputhet edhe me provat tjera nga shkresat e çështjes, si fakti se ai i ka kthyer 5000€ më shumë se shuma e huazuar, pra 14.000€ ,ndërsa në shkresa gjendet edhe fletorja me shënime ku janë shënuar të dhënat për borxhet nga të dëmtuarit.

Pretendimi se aktgjykimi bazohet në deklaratat e të dëmtuarve dhënë në procedurë paraprake pa mundësinë e kundërshtimit nga ana e mbrojtjes po ashtu nuk është i bazuar, sepse të dëmtuarit kanë dhënë deklarata në shqyrtimin gjyqësor dhe palët kanë pasur mundësi të bëjnë pyetje dhe të kundërshtojnë të njëjtat. Fakti se ata i kanë ndërruar deklaratat dhe se në shqyrtim gjyqësor kanë mohuar se i nga i dënuari kanë huazuar para me fajde, është arsyetuar ligjërisht dhe në tërësi nga gjykata e shkallës së parë ndërsa edhe ajo e shkallës së dytë i ka dhënë arsyet se pse i ka pranuar si të drejta dhe ligjore.

Megjenëse, kjo Gjykatë gjeti se aktgjykimet nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara dhe ndaj të dënuarit H.I. nuk është shkelur ligji penal në dëm të tij, refuzoi kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK-së dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.60/2017, më 30 prill 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa